

20242564466

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROGRAMIN PËR
ENERGJI RIGJENERUESE EMV - KOMPONENTI II: EF MANASTIR 2 DHE
KOMPONENTI III: PARKU EOLIK BOGDANC - FAZA 2, QË DO TË LIDHET
NDËRMJET BANKËS KREDITORE PËR RINDËRTIM KFS DHE SHOQËRISË
AKSIONARE PËR PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE ELEKTRANAT E
MAQEDONISË SË VERIUT, NË PRONËSI SHTETËRORE, SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për Programin EMV për Energji Rigjeneruese - Komponenti II: EF Manastir 2 dhe Komponenti III: Parku Eolik Bogdanc - faza 2, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për rindërtim - KFS dhe Shoqërisë Aksionare për prodhim të energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, në shumë prej 55.000.000 euro, nëse Shoqëria Aksionare për prodhim të energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, nuk i plotëson dhe servison detyrimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfV dhe Shoqërisë Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup për financimin e Programit të Energjisë rigjeneruese EMV – Komponenti II: EF Manastir 2 dhe Komponenti III: Parku Eolik Bogdanc – faza 2.

Neni 3

Të gjitha detyrimet dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe shërbimi i huas, do të shlyhen nga Shoqëria Aksionare për prodhim të energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, nga të hyrat që i realizon në afate dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati për pagesë të huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë viteve.

Norma e interesit do të përcaktohet veçmas për secilin këst nga huaja gjatë tërheqjes së tyre.

Gjatë tërheqjes së secilit këst përlllogaritet normë interesi e matur mesatare dhe e njëjta do të aplikohet në shumën e tërhequr të huas.

Huaja do të paguhet me këste gjysmëvjetore, të cilat maturohen më 15 maj dhe 15 nëntor.

Neni 5

Shoqëria aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KfV provizion të njëhershëm në shumën prej 0.75% të shumës së huas para tërheqjes së transhit të parë të huas, ndërsa në afat prej tre muajve nga dita e lidhjes së Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji, Shoqëria aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup nuk e tërheq këstin e parë të huas, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KfV provizion të njëhershëm në vlerë prej 0,75% të shumës së huas.

Shoqëria aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion në vlerë prej 0,25% të mjeteve të patërhequra nga huaja në nivel vjetor, i cili paguhet në këste gjysmëvjetore, të cilat maturohen më 15 maj dhe 15 nëntor.

Provizionin nga mjetet e pa tërhequra nga paragrafi 2 i këtij neni, Shoqëria aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do të fillojë ta paguajë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.